**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE**

---

# VENDIM
**Nr. 15, Dt. 12.06.2008**

***Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, lumi Shushice, ne afersi te fshatit Bolen, per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Denyl" sh.p.k. Tirane.***

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-se nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U-it dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

## VENDOSI:

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit ujor, lumi Shushice, ne afersi te fshatit Bolen , per prodhim te energjise elektrike, subjektit "Denyl" sh.p.k. Tirane.
   Me veper marrje, ne piken me koordinata:
   X 1 = 44 54 100 Y1 = 43 92 870 Z = 250 m
   X 2 = 44 54 230 Y2 = 43 92 950

2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete 6.5 m³/sek.

3. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithe vitit, duke i zbritur periudhen nga 1 Qershor deri me 30 shtator te cdo viti, sasine e ujit qe do te nevojitet per ujitjen e tokave bujqesore, prej 1.2 m³/sek

4. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.

5. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**KRYETARI I K.B.U-se "VJOSE"**
**Xhevair REXHEPI**

**PERGJEGJESI I A.U.B-se "VJOSE"**
**Vezir METAJ**